



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AA.nr.1/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Ragip Namani anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj subjektit hetimor L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së gjyqtarit, paraqitur kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK nr.568/2023, datë 21.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 22.01.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., paraqitur kundër Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr.568/2023 të datës 21.12.2023.

### A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK. nr.568/2023 të datës 21.12.2023, konstatohet se, L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 5 par.2, nën par.2.7 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 5, pika 5.1 dhe 5.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. Në pikën II të dispozitivit të vendimit të KGJK-së, për shkeljen disiplinore të përcaktuar në pjesën I të këtij vendimi, gjyqtarit L. B., i shqiptohet sanksioni disiplinor transferim i përhershëm nga Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal të Gjykatës Themelore në Prizren, në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje të njëjtës gjykatë.

Kundër këtij vendimi gjyqtari L. B., në afat ligjor, ka paraqitur ankesë, për shkak të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës, me propozim që, siç thuhet në të, të aprovohet si e bazuar ankesa e gjyqtarit, dhe të ndryshohet vendimi i goditur i KGJK-së, dhe të ndryshohet vendimi i atakuar vetëm sa i përket sanksionit disiplinor të shqiptuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) nëpërmjet të cilës kundërshton thëniet ankimore, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të goditur, në kuptim të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe shkresave të lëndës si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesë, gjeti se,

Ankesa e gjyqtarit Luan Berisha është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje Këshilli) me datë 03.04.2023, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor me pretendim se L. B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sipas të gjeturave dhe vlerësimit të Autoritetit Kompetent gjyqtari L. B., ka bërë shkelje të rëndë disiplinore duke mos ndërmarr veprimet konform përgjegjësive të tij gjyqësore zyrtare, dhe si rrjedhojë e mangësive të konstatuara ka ardhur gjerë te humbja e besimit të publikut në vendosje të drejtë dhe në mënyrë meritore. Respektivisht sipas Autoritetit Kompetent gjatë punës së tij si gjyqtar ka qenë i ngarkuar me 668 lëndë të cilat i kishte pranuar në mënyrë proporcionale si çdo gjyqtar tjetër i divizionit penal në Gjykatën Themelore në P.

Sipas vlerësimit të autoriteti gjatë punës së tij si gjyqtar nuk ka mundur ta organizoj dhe menaxhoj punën e tij rreth caktimit dhe organizimit të detyrave të punës kështu që bazuar edhe në raportet e paraqitura nga vet subjekti i hetimit janë parashkruar një numër i konsiderueshëm i lëndëve penale. Në bazë të verifikimit të Autoritetit Kompetent bërë subjektit të hetimit në vitin 2013 i janë parashkruar 30 lëndë me parashkrim relativ (absolut), në vitin 2014 i janë parashkruar 19 lëndë, në vitin 2015 i janë parashkruar 38 lëndë nga këto 30 lëndë me parashkrim relativ dhe 8 lëndë me parashkrim absolut, në vitin 2016 i janë parashkruar 65 lëndë, prej tyre 50 lëndë me parashkrim absolut dhe 15 lëndë me parashkrim relativ dhe pa asnjë veprim të ndërmarr. Nga kjo gjendje në total për katër (4) vite 2013, 2014, 2015, 2016, subjektit të hetimit i janë parashkruar 152 lëndë gjyqësore, dhe janë edhe 214 lëndë që për shkak të periudhës së gjatë të kaluar pa ndërmarr asnjë veprim pritet që të nxjerrën vendime për parashkrim. Prandaj bazuar në këto të gjeturat ka vlerësuar se ka bazë për iniciimin e procedurës disiplinore dhe kërkoi nga KGJK themelimin e panelit hetimor.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 06.04.2023 ka themeluar panelin hetimor i cili panel ka zhvilluar hetimet dhe me datë 27.04. 2023 i ka dorëzuar KGJK-së raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura si dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë të arritur në mes të panelit hetimor dhe subjektit të hetimit gjyqtarit L. B., si dhe sanksionin disiplinor zvogëlim i pagës për 30% për periudhën kohore për një (1) vit.

Me datë 28 korrik 2023, KGJK ka mbajtur seancë dëgjimore, pa prezencën e kryesuesit të panelit hetimor dhe subjektit të hetimit. Në seancën dëgjimore të datës 21.09. 2023, KGJK ka vendosur për përgjegjësinë disiplinore të subjektit të hetimit në atë mënyrë që subjekti i hetimit është shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore të nenit 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit 06/L- 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Për shkeljen e theksuar i ka shqiptuar sanksionin disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës për 20% për periudhën kohore prej 1 (një) viti, dhe transferim i përhershëm nga Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal të Gjykatës Themelore në Prizren, në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje i të njëjtës gjykatë.

Subjekti i hetimit i pakënaqur me vendimin e KGJK ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme ndërsa Gjykata Supreme me aktvendimin AA.nr.48/203, të datës 08.11.2023, e ka pranuar si të themeltë ankesën e subjektit të hetimit, e ka prishur vendimin e KGJK- dhe e ka kthyer në rishqyrtim çështjen.

KGJK, pas pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme ka kërkuar plotësimin e raportit të panelit të hetimit për çështjet që ka rekomanduar Gjykata Supreme, ndërsa paneli i hetimit me datën 14.12.2023 e ka plotësuar raportin duke ia dorëzuar të njëjtin KGJK-së. Në procedurë të rregullt, KGJK me datën 21.12 2023, ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën ka prezantuar kryesuesja e panelit hetimor dhe subjekti i hetimit gjyqtari L. B. Në këtë seancë përveç provave të administruara në procesin e mëparshëm në këtë çështje disiplinore është marrë në administrim edhe raporti plotësues duke ju dhënë njëkohësisht mundësia edhe kryesueses së panelit dhe gjyqtarit subjekt i hetimit që të shprehin pikëpamjet e tyre me rastin e rishqyrtimit të çështjes.

Pas kthimit të çështjes nga Gjykata Supreme është hartuar edhe raporti plotësues nga ka rezultuar se gjyqtarit i janë parashkruar çështjet me të cilat ka qenë i ngarkuar dhe atë: të vitit 2013 i janë parashkruar 30 lëndë, të vitit 2014 i janë parashkruar 19 lëndë, të vitit 2015 janë parashkruar 38 nga këto 30 lëndë me parashkrim relativ dhe 8 me parashkrim absolut, në vitin 2016 janë parashkruar 65 lëndë, prej tyre 50 lëndë me parashkrim absolut dhe 15 lëndë me parashkrim relativ pa u ndërmarrë

asnjë veprim. Nga kjo gjendje në total për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, subjektit të hetimit i janë parashkruar 152 lëndë gjyqësore dhe janë edhe 214 lëndë, që për shkak të periudhës së gjatë të kaluar rreth 24 muaj, pa u ndërmarrë asnjë veprim dhe pritet që të nxirren vetëm vendimet për parashkrim.

Ndërsa subjekti i hetimit në seancën e datës 21.01. 2023, ka deklaruar se e pranon fajësinë duke e arsyetuar me mbingarkesën me lëndë gjyqësore si dhe angazhimin e tij si anëtarë në trupat gjykues në seancat gjyqësore në Gjykatën Themelore në P. Më tej, subjekti i hetimit thekson se këto lëshime nuk janë bërë me dashje as me qëllim, dhe nuk do të përsëriten më. I njëjti ka deklaruar se është vlerësuar mirë për punën që e ka kryer si gjyqtar, nga komisioni për vlerësim. Ka shtuar se nga momenti kur menaxhmenti i gjykatës e ka mbështetur me staf profesional në kohën e fundit gjendja është përmirësuar dukshëm në zyrën e tij, gjë që nënkupton se gjendja e mëparshme është krijuar si shkak i mbingarkesës dhe përfshirjen e gjyqtarit në shume aktivitete brenda gjykatës, prandaj pavarësisht përpjekjeve maksimale të tij ka qenë e pamundur të evitohet gjendja e krijuar. Në këtë kuptim i ka kërkuar KGJK-së që të ketë në konsideratë faktin se gjyqtari është me eksperiencë të gjatë, gjatë tërë karrierës së tij ka demonstruar sjellje me integritet të lartë dhe nuk është përfshirë në asnjë shkelje disiplinore.

Këshilli ka gjetur se subjekti i hetimit gjyqtari Luan Berisha është përfshirë në shkelje disiplinore të rëndë siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent duke mos ndërmarrë veprimet e nevojshme për procedim të lëndëve penale konform dispozitave ligjore. Duke u bazuar në raportet statistikore lidhur me ngarkesën me lëndë është vërtetuar se nga numri i lëndëve me te cilat ka qenë i ngarkuar gjyqtari ne periudhën prej katër viteve janë parashkruar lendet e përshkruara më lartë. KGJK ka konstatuar se gjyqtari ka dështuar të administroj zyrën dhe rrjedhimisht të përshtat angazhimin e tij varësisht nga vëllimi i ngarkesës dhe i prioriteti brenda zyrës. Nuk është kontestuese se gjyqtari subjekt i hetimit ka qenë i angazhuar edhe në Departamentin e Krimeve të Rënda në shumë çështje gjë që ka ndikuar pashmangshëm edhe në efikasitetin e punës se tij në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal, mirëpo ka qenë në përgjegjësinë e gjyqtarit që ti caktoj prioritetet dhe në këtë rast prioritet ka qenë evitimi i parashkrimit të lëndëve.

Si rrjedhojë e kësaj gjendje është humbur besimi i publikut në vendosje të drejtë dhe është humb mundësia që të vendoset në mënyrë meritore për lëndët e parashkruara. Bazuar në raportet statistikore të pranuar nga zyrat kompetente, KGJK po ashtu ka gjetur se subjekti i hetimit gjyqtari Luan Berisha ka qenë i ngarkuar me lëndë në mënyrë proporcionale sikurse të gjithë gjyqtarët tjerë të divizionit penal të Gjykatës Themelore në Prizren, mirëpo nuk ka organizuar punën dhe nuk kishte

ndërmarrë veprime konkrete me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës, ku në rastin konkret ka dështuar në kryerjen e detyrave të tij si gjyqtar.

KGJK ka gjetur se veprimet e gjyqtarit Luan Berisha i kanë cenuar parimet bazë të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe përgjegjësisë që ka gjyqësori, për të promovuar vlerat e trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit dhe para gjykatës si dhe vlerat e publikut që të besojnë në drejtësi të paanshme.

Shkeljet e sipër theksuara janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar edhe KGJK-së nga raportet fakt mbledhëse të panelit hetimor. Këto raporte të panelit janë vlerësuar të besueshme pasi që paneli, në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Këshilli ka vlerësuar pretendimet e subjektit, por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara, këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që KGJK të marrë një vendim tjetër. Në seancën për këshillim dhe votim, KGJK në mënyrë unanime konstatoj se subjekti i hetimit gjyqtari L. B., është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5-shkelje disiplinore për gjyqtare, paragrafi 2-shkeljet e detyrave të gjyqtarit qoftë me dashje qoftë nga pakujdesia e rëndë, dhe nën paragrafi 2.7-në vazhdimësi nuk i kryen detyrat me kohë, siç kërkohet me ligj, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 5-funksioni i gjyqtarit ka prioritet kundrejt të gjitha aktiviteteve tjera të gjyqtarit, dhe 5.2, -gjyqtari është i detyruar që të organizoj punën brenda orarit të punës me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës, të përcaktuara në Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Këshilli shqyrtoi të gjitha rrethanat në të cilat ka vepruar gjyqtari si subjekt i hetimit dhe në përputhje me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka vlerësuar se masë adekuate për këtë shkelje disiplinore të konstatuar është sanksioni transferim i përhershëm nga Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal të Gjykatës Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje të njëjtës gjykatë, për të cilat Këshilli ka vlerësuar se janë në përputhje të plotë me shkeljet e konsumuara.

Masën disiplinore të degradimit - transfer i përhershëm nga Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal të Gjykatës Themelore në P., në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje të njëjtës gjykatë, Këshilli e ka vlerësuar si sanksion të përshtatshëm dhe adekuat duke marrë parasysh natyrën e lëndëve të cilat shqyrtohen dhe trajtohen në këtë divizion. Në bazë të raportit të panelit hetimor por edhe vet deklarimit të subjektit të hetimit gjyqtarit Luan

Berisha është konstatuar se i njëjti për vite të tëra ka neglizhuar punën si Gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm Penal dhe në vijueshmëri ka pas parashkrim të lëndëve, me çka nën rrethanën e tillë vazhdimi i punës se të njëjtit gjyqtar pran departamentit ku ka punuar gjer me tani do të ishte tërësisht i paarsyeshëm, pasi qe gjyqtari lehtësisht do të përsëriste të njëjtat shkelje.

Si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të sanksioneve disiplinore, KGJK mori atë se subjekti i hetimit nuk ka qenë asnjëherë në procedurë disiplinore dhe se i njëjti ka shprehur keqardhje lidhur me situatën e ndodhur dhe ka premtuar para KGJK-së se nuk do të lejoj që të përsëritet situatë e njëjtë. Masa disiplinore e shqiptuar sipas vlerësimit të KGJK-së është masë proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit duke siguruar kështu zbatimin e përgjegjësiive ligjore që ka Këshilli në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve e cila procedurë bazohet në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Masa disiplinore sipas Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duhet të jetë masa e cila ndikon te gjyqtari subjekt i hetimit që ti korrektoj veprimet, gjatë ushtrimit të funksionit të tij si gjyqtarë.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është i ligjshëm dhe është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit L. B., për shkeljen disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me qëndrimin se shkeljet e sipër theksuara janë provuar gjatë administrimit të provave, të cilat i janë prezantuar Këshillit, nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor, i cili është vlerësuar si raport i besueshëm pasi që në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore Paneli ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve siç janë tabelat e lëndëve të parashkruara raportet dhe kopjet e aktvendimeve për lëndët e parashkruara.

Subjekti hetimor, Gjyqtari L. B., në ankesë konfirmon se raportin e lëndëve të mbetura të datës 02.03.2023 nuk e ka kontestuar as gjatë periudhës hetimore e as tani në ankesë nuk e konteston. Ai pretendon në ankesë se e ka respektuar brenda mundësive, parimin e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies. Pretendimet e njëjta si në procedurën hetimore dhe para KGJK-së janë paraqitur në ankesë duke cekur se numri i madh i lëndëve, angazhimi në trupa gjykuese në Departamentin e krimeve të rëndë, mungesa e zyrtarit ligjor dhe fakti se edhe në kohën kur ka qenë e angazhuar zyrtarja ligjore ka pas vështirësi sepse ka qenë e nacionalitetit turk dhe në gjuhën shqipe kishte vështirësi të punës. Duke marrë për bazë faktin se nuk ka pas asnjë vërejtje gjatë karrierës si gjyqtarë dhe ani së fundi

pretendon se ka ndryshime në aspektin e rezultatit pozitiv dhe për këtë arsye kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta ndryshoi vendimin e KGJK-së vetëm në pjesën e sanksionit disiplinor.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi këto pretendime dhe gjeti se të njëjta janë të pa bazuara nga se subjekti i hetimit gjyqtari L. B., është përfshirë në shkelje disiplinore të rëndë siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent duke mos ndërmarrë veprimet e nevojshme për procedim të lëndëve penale konform dispozitave ligjore.

Në procedurën e përsëritur nga KGJ u shqyrtuan pretendimet e palëve dhe rekomandimet e Gjykatës Supreme të Kosovës. Për kësaj, KGJK ka mbajtur seancë dëgjimore më 21.12.2023 në të cilën ka marr pjesë subjekti hetimor, gjyqtari L. B., dhe Kryesuesja e Panelit Hetimor. Në këtë seancë subjekti i hetimit e ka pranuar fajësinë dhe ka theksuar se këto lëshime nuk janë bërë me qëllim dhe se nuk do të përsëritën në të ardhmen. Subjekti hetimor nuk i ka kontestuar të dhënat nga raporti hetimor dhe raporti istatistikave lidhur me lëndët e ngarkuara dhe të parashkuara.

Sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është hequr paqartësia rreth parashkrimit të përgjegjësisë disiplinore raporti i ri hetimor e vërteton përgjegjësinë e gjyqtarit për 121 lëndët e parashkuara në 5 vitet e fundit. Në shkresat e lëndës janë bashkangjitur raporti hetimor i datës 14.12.2023 dhe tabela me lëndët e parashkuara si dhe aktvendimet e nxjerra nga subjekti hetimor i cili këto të dhëna nuk i mohon. Kjo nënkupton se në asnjë mënyrë nuk është parashkruar shkelja disiplinore, dhe gjithashtu qëndron edhe vlerësimi i KGJK-së se gjyqtari mban përgjegjësi edhe për pjesën tjetër të lëndëve në të cilat ka kaluar afati prej 5 viteve nga momenti i parashkrimit e deri të momenti i fillimit të procedurës disiplinore pasi që gjyqtari rastet i ka mbajtur në zyrë pa i nxjerr vendimet e parashkrimit dhe rrjedhimisht u ka pamundësuar palëve të dëmtuar që të fillojnë kontestet në procedurë civile.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon edhe qëndrimin se masa disiplinore e shqiptuar është proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit dhe është në zbatimin e përgjegjësive ligjore që ka Këshilli Gjyqësor në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjykata Supreme gjeti se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KPK-së, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pika 4 e këtij neni parasheh se ankesa ndaj vendimeve të Këshillit mund të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të Ligjit (4.1) dhe në rast në rast të një gabimi faktik të

qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës (4.3).

Bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Vendimit të KGJK-së, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa e subjektit hetimor, e ushtruar ndaj vendimit të KGJK-së nuk mbështetet në fakte. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është dëshmuar se është bërë shkelje disiplinore nga parashtruesja e ankesës, dhe të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ka marrë parasysh edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja. Prandaj pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të së drejtës materiale janë të pa bazuara dhe si të tilla u refuzuan.

Në këtë rast KGJK konstaton është vlerësuar përgjegjësia e gjyqtarit për 121 lëndët e parashkruara në 5 vitet e fundit që nënkupton se në asnjë mënyrë nuk është parashkruar shkelja disiplinore, por në vlerësimin e KGJK-së gjyqtari mban përgjegjësi edhe për pjesën tjetër të lëndëve në të cilat ka kaluar afati prej 5 viteve nga momenti i parashkrimit e deri të momenti i fillimit të procedurës disiplinore pasi që gjyqtari rastet i ka mbajtur në zyrë pa i nxjerr vendimet e parashkrimit dhe rrjedhimisht u ka pamundësuar palëve të dëmtuar që të fillojnë kontestet në procedurë civile.

Gjykata Supreme konsideron se shkelja është e paraparë me nenin 5.2.7, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili parasheh se Gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse "në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj;" dhe sanksioni disiplinor i shqiptuar është në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.4; të njëjtit ligj. Prandaj nëse i referohemi këtyre dispozitave del se është zbatuar procedura e paraparë sipas ligjit në fuqi dhe masa e dhënë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtari, pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; ky sanksion disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor ashtu siç parashihet në nenin 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në vështrim të dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës është e detyruar të kufizohet në shkaqet e parapara në Ligj për të cilat mund të paraqitet ankesa (nenin 15, pika 4.1 deri pika 4.3 të Ligjit), dhe atë vetëm në rast të zbatimit të gabuar të ligjit; në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj; apo në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale



të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës;) dhe në rastin konkret asnjëra nga këto shkaqe nuk janë përmbushur.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 15.6 dhe 9 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prourorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.1/2024 datë 22.01.2024

Kryetari kolegjit,

Beshir Islami